

MUSTAFA HAXHI
UNË I THEM, TI I GJEN

GJËEGJËZA

BOTIMET TOENA

Mustafa Haxhi

*Unë i them
ti i gjen*

gjëgjëza



BOTIMET TOENA

Tiranë, 2021

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 978-9928-348-53-1

©Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

*Ua kushtoj me dashuri Irisit, Liamit dhe Aronit,
mbesës dhe nipave,
si dhe gjithë bashkëmoshatarëve të tyre kudo që ndodhen.*

Autori

Kushtim:

GJËEGJËZA PËR JU FËMIJË

*Mendja ku nuk më shkoi,
gjëegjëza për ju grumbulloj...
Hape në faqen e parë:
gjëegjëzat janë vënë në radhë.*

*Kureshtjen do të shtoni
kur librin do të shfletoni.
Janë të lehta a të rënda,
ka një sekret aty brenda.*

*Kur je lodhur në studim,
lër një çast e bëj pushim,
gjëegjëzat lexo pak nga pak;
po i gjete i ke hak.*

*Bleta mjaltin si e bën?
Punon shumë, s'rri në vend,
ndaj që në klasë të parë
me shokët të jesh në garë.*

*Dijen ta kesh të shenjtë,
shkëlqe ku të kesh talent,
janë për ju këto gjëegjëza,
vra mendjen, gjeji të tëra.*

*Kupton pak kur i fillon,
i gjen, gëzon e fluturon...
Fëmijë, ky është qëllimi:
lexoni që më shumë të dini.*

*Kënaqësia t'u ketë mbetur,
gjëegjëzat kur t'i keni gjetur,
ju mendjen e vutë në punë...
Vallë, ç'notë do të marr unë?*





*Me tela qenka ndërtuar
e nga forma si shtëpi,
brenda janë duke kënduar
zogj me qindra melodi.*

Kush e gjen cili është ky?

k _ f _ _ _

*Jam një frutë, më keni mike,
vij nga larg që prej Afrike.*

*Nga të gjithë jam e kërkuar,
ngjyrëverdhë e trupharkuar.*

*Brenda e ëmbël e plot shije...
Hë, vogëlush, në mend s'të bie?*



b _ n _ _ _ a



*E bedh mami, e bedh motra
nëpër faqe e nën gushë.*

*Oh, ç'aromë kur del nga porta!
Gjeje shpejt, o vogëlush!*

p _ _ _ u _ _

*Një ditë dimri me stubi,
nuk bie as borë, as shi.*

*Bien kokrra si kristali,
kush do ta thotë i pari?*



b _ _ s _ _ _ _



*S'lundroj mbi det e oqean,
të çaj dallgë e të bëj shkumë,
futem thellë me peshqit pranë,
si e kam, vallë, emrin unë?*

n _ _ d _ _ _ j _

*Prej qelqi është e ndërtuar,
në gosti e gjen shpesh,
e mbushim, bëjmë: "Gëzuar!".
Cila është, mund ta gjes?*



g _ t _



*Mbi faqe dhe nën vetull
si dylbi rrinë të paepur.*

*Pa ata njeriu s'rrri
ndryshe shkon në verbëri.*

s _ t _

*Mbi çdo kafshë vendos vetë,
i fuqishëm, qubet mbret.*

*Një madhosh kokë paqethur,
këmbëshpejtë e dhëmbëbukur.*

*Ha zebra, buaj e drerë
të rritur e të sapolerë.*



l _ _ _ i



*Shkon në fshat dhe në qytet,
kalon kufi në çdo shtet,
e shpërndan postieri vetë,
brenda tij mban një sekret.*

*Qoftë i bardhë, apo i verdhë,
një adresë mbi të është hedh.*

z _ _ f _

*Pak e thellë e rrumbullake,
baltore a porcelan,
të jepet me gjellë në vakte
ndaj të duket shpirt e xhan.*



p _ _ _ a



*Në pranverë lule të bardha,
në verë të verdha, kuqaloshë,
brenda vetes ka ca fara
ka të ëmbla dhe majhoshe¹.*

m _ l _ _

*Ai mbi shina rrëshqet
nga qyteti në qytet,
njëra si kabinë prin,
lidhur pas të tjerat vijnë.
Kur borinë e tij dëgjon,
mbyll veshët se të shurdhon.*



t _ _ n _



*Me dy brirë, me trup të rëndë,
jam i fortë për parmendë,*

*me bujkun jam shumë mik
edhe pse më vë tevlík².*

*Më shpon pas me hosten³.
Hë, fëmijë, kush po e gjen?*

k _ u

*Në nëntor mblidhet kjo frutë,
kur piqet bëhet e butë.*

*E ëmbël forma rrumbullake,
janë dy lloje si binjake.*

*Njëra-tjetrës i thotë: unë jam e para,
ti e thjeshtë, unë plot fara.*

A e gjen dot ti Sara?



h _ _ m _



*Jam e vogël, s'peshoj rëndë,
fluturoj, por nuk kam pendë,
përmbi dy krahët e mia
është derdhur tërë bukuria.*

*Çelin lulet si përherë,
kur më sheh, ka ardhur pranvera.*

f _ _ t _ _ _

*Mjet që punon në arë
me ca plugje bën ugar.*

*Kur punon gërr-gërr gjëmon,
mbyll veshët se të shurdhon.*

*Katër rrota ky mjet ka
dy të vogla, dy të mëdha.*



z _ _ o _ _

*Varur te dashi me bri
mjeti që bën melodi.*



*Ka lezet dhe i ka hije
kur ajo poshtë gushës bie
dhe ca dele kanë nën gushë...*

Kush e gjen, o vogëlushë?

k _ _ b _ _ a⁴

*I vogël, shumë frikacak,
si rrufeja ikën vrap.*

*Ka dy veshë goxha të gjatë,
shumë gjathtarë e zënë në lak.*

*Katër këmbë që fluturojnë
nga qenushët e shpëtojnë.*



l _ p _ _ _



*Pushon shiu, ai del,
këmbët hedh breg më breg,
shtatë ngjyrat ka harkuar,
poshtë fëmijë të gëzuar.*

y _ _ e _ _

*Herë i qetë e herë i fortë
bie shiu poshtë në tokë.*

*Kthehet avull përsëri
ik e ik në lartësi.*

*Atje, ju fëmijë ta dini,
ndodh çudia, bëhet shndërrimi,
nga i ngrohtë në të ftohtë
bie flokë-flokë mbi tokë.*



b _ _ a



*Punëtori e mban në dorë.
Zhap e zhup ngarkon zhavorr,
bishti dru e kreu hekur...*

Të lumtë ty, që e ke gjetur!

l _ _ a _ _

*Hyn shoferi në makinë,
duart mbi atë i rrinë.
E dredh dhe e rrotullon,
pa atë nuk ke ku shkon.*

*Brenda tij një buton rri,
kur e shkel bën pi-pi-pi.*



t _ _ _ n _



*E varur qëndron në mur
brenda saj rri një pikturë,
portrete, fotografi
i kemi gjithmonë në sy.*

Cila është, e gjen dot ti?

k _ _ _ _ z _

*Në lëndina, në livadhe
atje rrojmë, s'trembemi fare.*

*Kërcej përpara e prapa,
kam dy këmbë shumë të gjata.*

*S'jemi shpendë, jemi insekte,
ushqehemi me bar e gjethe.*

*Unë kërcej hop e hop.
Nga ju, kush më gjen dot?*



k _ _ k _ _ _ c _



*Nga zhardhoku vij vërtet,
Dhe më bejnë fetë-fetë.
Me pak kripë e me shumë shije,
Sa i pëlqen çdo fëmije!
Pres e paketuar në raft,*

Hë Liam, a më gjen pak?!

p _ _ _ a _ _ _ _ _

*Është simboli shqiptar,
ndaj për të jemi krenarë.*

*Në festa, në përvjetor
e valëvitim dorë më dorë.*



f _ _ _ a _ _ _ _ _



*Në dhomë përballë është vënë,
jep filma, koncerte e këngë.
S'të bën dora për ta fikur,
shobin të vegjël e të rritur.*

t _ _ _ _ v _ _ _ _ _

*Qoftë nga beze a lëkurë
nga xhepi s'e heqim kurrë.*

*I vogël, por si hambar
me lekë, euro e dollarë...*

Kush e gjen nga ju më parë?



p _ _ t _ _ _ i

*Kalit me peshë të rëndë
çfarë i vendosim nën këmbë?*



*Një metal si shkronja "U"
mos ta vrasin gurë e dru.*

*Ka dbe tetë vrime në të,
Kush nga ju e gjen këtë?*

p _ _ k _ _

*I thurur me flokë e push⁵
dhomën na e bën të butë.*

*Është i bukur ngjyra - ngjyra,
mbi të lozim, bëjmë detyra.*

*Mbi të mami kalon fshesën,
cili është ky, po ju pyes?*



q _ _ _ m _



*E kemi rreth në shtëpi,
shpendin që na sjell dobi.
Bën ka-ka, pra kakaris
para se punën ta nisë.*

*Thonë po bëri ka-ka-ka
ja e bëri, ja e ka.*

p _ _ _

*Ka të hollë, ka të trashë,
ka të shkurtër, ka të gjatë.*

*Trupi i tij me parafinë,
në mes i kalon një fill.*

*E ndezim në Shën Mëri,
në kisha e në xhami.*



q _ _ _ r _



*Brenda tij bukuri e rrallë,
peshq, ngjala dhe koralë⁶.*

*Lundrojnë anije e tragete
Hë, Iris, akoma s'e gjete?*

d _ _ _

*E thelluar nga një anë,
ana tjetër bisht i gjatë,
me atë ushqimin hamë
sa nuk mbetet gjë në pjatë.*



l _ _ _

*Jam një shpend pak më ndryshe,
bishti i gjatë plot me qëndisje.*



*Në botë s'ka si unë të bukur
se lë pas çdo zog e flutur.*

*Mburrem me bishtin kurorë,
mbret i parkut natyror.*

p _ _ _ o _

*Ta-ta-ta e ty-ty-ty,
jep sinjalin në ushtri.*

*Me këtë vegël frymore
hanë, flenë e bëjnë rreshtore.*



b _ r _ _



*Amvisa e kuzhinierë,
pa mua s'bëni dot gjellë.*

*Nga ngjyra ngjaj si sheqeri,
po shije të kundërt kemi.
Hë, si thoni, do më gjeni?*

k _ _ p _

*Hiq dhjetë e ngelen dhjetë
kur dimri në prag troket.*

*Janë rrobë a janë meshin,
mjaft duart mos të ngrijnë.*

*Kur vete e vjen nga shkolla,
ato mos i hiq nga dora.*



d _ r _ _ _ _ t



*Ecën ditë e ecën natë
shkon në det e gjen rehat.*

*Kur ka shi krijon dallgë,
brigjeve sulet të dalë.*

*Peshq e ngjalë rrëzat plot,
i pari kush do ta thotë?*

l _ _ i

*Ca burra, por jo të gjithë
e mbajnë ende një traditë.*

*Të kenë lart burrërinë,
mbi buzë ca qime u rrinë.*

*Të verdha, apo gështenjë,
pyet pak babin pse i lënë?*



m _ _ _ a _ _ t



*Kush i ndan sytë në mes,
kush rri mbi gojën që flet?*

*Mes fytyrës cila na rri,
ajër kush çon në mushkëri?*

Thuaje ti, se unë e di.

h _ _ _ a

*Është lëng, që del nga rrushi,
valëzon në kazan mushti,
nga llullani⁷ del curril,
bën gëzuar e të vjen mirë.*

*Po pive e teprove
iku mendja, shkalllove.*

*Të vegjlit duhet ta dinë,
Mos ta vënë në gojë r...*



r _ _ _ _



*Afron copa druri bashkë
në sobë, apo në oxhak,
me shkrepëse, ose çakmak
ndizen e shpërthen në flakë.*

*Doçkat ngroh e pranë i rri,
a më thua kush është ky?*

z _ _ r _ i

*Ngrihem kat mbi kat,
jam me gurë, tulla e llaç,
mbi mua pesha të rënda,
me suva jashtë e brenda.*

*Rrethoj kopshte e çerdhe,
me mua ngrenë grataçele⁸
nga themeli rriten kate,
ndërtoj kala edhe pallate.*



m _ _ _ t



*Prapa faqeve mbështetur
në kokë ngulur të dy rrinë,*

*Ata s'kanë kurrë për të fjetur
se dëgjojnë tingujt që vinë.*

v _ sh _ _

*Mes pajisjeve të shtëpisë
është dhe një amvisë e mirë,
jo me frymë, po aparaturë,
kur e ndez, gjëmon me zburmë.*

*Ajo ka kordon të gjatë,
punon brenda, jo në kat,
e përdor mami dhe nëna,
thith fije e pluhur brenda.*



f _ _ _ _ m _ k _ rr _ _ _

*Mbi përrenj, lumenj e dete,
po s'jam unë, ti s'ke ku vete.*



*Mbi të kalojnë trena e traktorë,
por jo tragete e avionë.*

*E ngritur me bekur e gurë,
ma gjej emrin, kush jam unë?*

u _ a

*Pa atë pantallonat s'rrinë,
e mbërthen rreth belit fort.*

*Fut mirë tokëzën në një vrimë
dhe del i sigurt në portë.*



r _ _ p _



*Parazit, s'tërhiqet fare,
rron struktur nëpër livadhe.*

*Kur kafshët kullosin bar,
ajo u ngjitet pa u parë.*

*Tani thotë e kam me hak
të ngul kokën, të pi gjak.*

*Thith e thith bëhet kacek
pastaj çahet e kërcet.*

k _ _ u _ _ _

*Kacavirret nëpër dru,
hop atje e hop këtu.*

*Mbi pemë sikur loz cirk,
i shkathët pa pasur frikë.*

*Të voglin e mban mbi vete,
ushqehen me fruta e gjethe.*



m _ _ m _ _ _



*Kur bie dimrit në shtrat,
me se vallë je mbuluar?*

*Brenda tij, oh sa rehat,
nuk të bëhet për t'u zgjuar.*

j _ _ g _ _ i

*Një metal i gjatë me majë,
kalorësit e mbajnë në brez,
kur del nga këllëfi i saj,
vret e pret e luftën ndez.*

Cila është kjo? - po ju pyes.



s _ _ _ t _

*I mbështjellë me shtatë palë,
rreshtat brenda radhë-radhë.*



*Bimën e rritim te toka,
në mulli e bluan rrota.*

*S'është grurë, po më i trashë,
bëhet bukë edhe kulaç.*

m _ _ _ r _

*Kjo bimë rritet në arë
rrumbullak plot tul e farë.*

*Është i madh, është i rëndë,
shumë i ëmbël për të ngrënë.*

*Ngjan dhe me pjeprin pak,
brenda tij i kuq flakë.*



s _ _ _ l _ _ _ i



*Me dorezë, i hollë e i gjatë,
në dorë e mban çdo plak,
e ngul dhe mbi të peshon,
këmbë e tretë sa e ndihmon.*

Gjyshi pa të s'ka ku shkon.

b _ s _ _ _ _

*Si kjo kafshë s'keni parë tjetër,
e veçantë, një racë e vjetër.*

*Bardhë e zi vijat në trup,
rron me bar, jeton në grup.*

*Më shumë jeton në Afrikë,
zbutet lehtë, mund ta bësh mik.*



z _ _ _ r _ _



*Me se e pastrojmë oborrin?
Në kopshte, shkollë e zyrë,
rreth e qark gjithë territorin
të shkëlqejë, kudo të ndrijë.*

*Është me qime, bishtgjatë,
çdo pëllëmbë e bën paq.*

f _ _ e _ _

*Ma jep mami në dorë.
Sa fillon të bjerë shi,
mbi kokë më rri si kurorë,
s'më lag udha shkollë-shtëpi.*

Cila është, ma thua dot ti?



e _ _ r _



*I kanë të mbirë mbi kokë çjapi,
dashi, lopa, dhia,
po dreri qëndron mbi shokë.*

Besoj lehtë e gjen fëmija.

b _ _ r _ _

*Kafshë që të ngjall habi,
shtatë ditë ujë nuk pi.*

*Ecën nëpër Saharë⁹
sa pesha mbi vete mban!*

*Ka dy gunga, dy të dala
atje ku vendoset shala.*



d _ v _ _ _



Është një vegël muzikore
me kacek e me tastierë.

E vë xhaxhi si gjoksore,
e pastaj fillon t'i bjerë.

Ka dy rripa prej meshini
se mbahet në krah, ta dini.

f _ _ z _ _ _ i _ _

E vogël, po sa punë ndreq
kur dora për keq rrëshqet.

Sbkruajmë me lapsa e ngjyra,
bëjmë figura dhe detyra.

Atje ku sbkruajmë gabim,
ajo fshin, e bën shkëlqim.



g _ _ _ f _ _ _ r _ _ _

Hap e mbyll, pa atë s'rrimë
tualet edhe kuzhinë.

Lajmë duar e fytyrë,
freskohemi e na vjen mirë.

Është metal që shkëlqen.
Kush nga ju fëmijë e gjen?



ç _ _ z _ _

*E shikon e të shikon,
çdo veprim ta kopjon.*

*Kur buzët s'i ke larë mirë,
shiko pak në p...*



p _ _ q _ _ _

*Unë kur në këmbë rri,
zgjatem plot në lartësi.*



*Rroj me gjethe, përtyp dru,
s'ha dot bar, e kam nën gju.*

*I them vetes: - Je pa fat,
ç'është kjo qafë kaq e gjatë?*

g _ _ r _ _ _

*Në klasë, në dërrasë të zezë
shkruan shkumësi disa herë.
Kur mbushet dërrasa plot,
ne s'mund të shkruajmë dot.*

*Që të shkruajmë përsëri,
me se i heqim, e gjen dot ti?*



f _ _ r _ _ d _ _ _ _



Lëng që nxirret nga toka,
përdoret nga gjithë bota.

Ç'ka motor, makineri,
po s'e pati, në vend rri.

Cila është, e gjen dot ti?

n _ _ t _

Rrobat kur në tel janë tharë,
shkon mami për t'i marrë.

Teshtat një nga një i shtrin
mbi shtresën në tavolinë.

Kë merr dhe vendos në prizë
që rrudhat t'i heq më mirë?



h _ _ _ r _ i r _ _ b _ _ _



Tridhjetë e dy ustallarë
ne i kemi vënë në garë.

Të mprehtë e me përvojë,
bluajnë si mulli në gojë.

d _ _ m _ _ _